



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 461, datë 23/ 05 /2017**

**Për**

**“Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Juliana	LATIFI	Kryetare
Eduard	YPI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Leida	MATJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Relacionit “Mbi monitorimin e tregut te telefonisë celulare me parapagese”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 24, shkronja d, dhe neni 26.  
Ligji nr. 44/2015 datë 30. 04. 2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Monitorimit të Tregut të Telefonisë celulare me parapagese” nga Sektori i Analizës dhe Studimit dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

**KONSTATOI:**

1. Nisur nga ankesat e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nga Qendra “Konsumatori Shqiptar”, si dhe 3 ankimes me objekt "Hetimi i tregut te telefonisë celulare ne lidhje me shfaqjen e praktikave te koordinuara dhe abuzimin me pozitën dominuese" për planet tarifore që ofrojnë për publikun e telefonisë celulare, Sekretariati në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”( këtu e vijim-Ligji) ka monitoruar tregun e shërbimit të telefonisë celulare. Nga monitorimi ka rezultuar se disa nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimet në këtë treg kanë ndryshuar paketat për klientët me parapagim.

2. Tregu përkatës i produktit është tregu me pakicë i shërbimeve celulare dhe analiza e konkurrencës është fokusuar në sjelljen ndaj çmimit të ofertave, sipas ndërmarrjeve në tregun përkatës. Tregu celular me pakice përfshin si shërbimet tradicionale të telefonisë dhe mesazheve SMS dhe ato të aksesit broadband në Internet nga rrjete celulare. Gjithsesi analiza fokusohet edhe në segmente të veçanta të përdoruesve/shërbimeve si ato me kontrate dhe parapagim. Sipas statistikave të rregullatorit AKEP, klientët me parapagim përbëjnë rreth 90% të numrit të klientëve të ndërmarrjeve celulare.
3. Referuar informacionit të mbledhur gjatë monitorimit, rezulton se tre shoqëri kanë ndryshuar paketat standarte në periudhën 27 mars 2017 - 4 prill 2017 në një sjellje të mundshme të koordinuar sipas parashikimeve të nenit 3, pika 4 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe që në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.
4. Gjithashtu bazuar në të dhënat e rregullatorit AKEP, rezulton se tregu i telefonisë celulare ka strukturën e një tregu oligopolistik me një operator me pozitë dominuese në tregun përkatës të shërbimeve celulare me pakicë, si dhe dy ndërmarrje të tjera me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut. Të tre ndërmarrjet zotërojnë bashkërisht rreth 95 % në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit nr.9121/2003, ekziston mundësia edhe për të abuzuar me pozitën dominuese në treg.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4; 9; dhe 42; të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), të nenit 4 të Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për Funksonimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare për të hetuar nëse ka, apo jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Periudha e Hetimit Paraprak do të jetë 1 Janari 2016 deri në 23 Maj 2017.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi tek palët objekt-hetimi dhe ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në legjisllacionin përkatës.
4. Raportit të hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komision jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**